

VENDIM
Nr. 799, datë 28.12.2023

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 465, DATË 26.7.2018, TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR
PËRMIRËSIMIN E NIVELIT TË KONTROLLIT TË MJETEVE MOTORIKE E
RIMORKIOVE TË TYRE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 88, të ligjit nr. 8308, datë 18.3.1998, “Për transportet rrugore”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 465, datë 26.7.2018, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

- a) Në pikën 7, togfjalëshi “... 31 dhjetor 2023.” zëvendësohet me “... 31 dhjetor 2024.”.
 - b) Pikat 1, 2, 3, 4 dhe 5, të aneksit I, ndryshohen, si më poshtë vijon:
 - “1. Pagesa e drejtuesit të Task-Forcës barazohet në pagë me nëpunësin civil të klasës I-4.
 2. Pagesa e anëtarëve të Task-Forcës barazohet në pagë me nëpunësin civil të klasës II-1.
 3. Pagesa e shefit të grupit të Task-Forcës barazohet në pagë me nëpunësin civil të klasës III-1.
 4. Pagesa e specialistit të grupit të Task-Forcës barazohet në pagë me nëpunësin civil të klasës IV-1.
 5. Pagesa e sekretarit/sekretares të/së drejtuesit të Task-Forcës barazohet me pagën minimale në shkallë vendi.”.
 2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama